



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1416/1 Prot.

Tiranë, më 08.10.2021

V E N D I M

Nr. 190, Datë 08.10.2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 72, datë 19.04.2021, të paraqitur nga E.L kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB), në të cilën pretendon për diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore” dhe “çdo shkak tjetër¹”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “Me Urdhërin nr. 2692/1, datë 25.03.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, është pezulluar nga detyra, si punonjës i rolit të mesëm, në Sektorin e Forcave Operacionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Ankuesi shprehet se shkak për pezullimin e tij nga detyra, ka shërbyer regjistrimi i procedimit penal nr. 2876/2019, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Vendimin nr. 3977, datë 30.09.2019, ka vendosur, pushimin e procedimit penal nr. 2876/2019, i cili ka marrë formë të prerë në datë 15.10.2019, pasi nuk është ankimuar. Duke qenë se procesi penal i filluar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka përfunduar duke konkluduar se nuk ka vepër penale, atëherë ka rënë dhe shkak i pezullimit të tij nga detyra. Me shkresën nr. 2958/E, datë 22.10.2019, ka kërkuar nga Drejtori i Përgjithshëm “Rikthimin në vendin e mëparshëm të punës, dhënien e të gjitha të drejtave administrative-financiare dhe pagimin e pagave mujore nga data e pezullimit 25.03.2019 deri në momentin e rikthimit në vendin e mëparshëm të punës”. Megjithëse kaluan mbi 6 muaj nga depozitimi i

¹ Pa përcaktuar një cilësi personale apo shkak.

kërkesës për rikthimin në detyrë dhe pagimin e pagave mujore, nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nuk u mor asnjë vendim. Më pas ankuesi me anë të një kërkesë padie, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në të cilën ka kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Urdhrit nr. 2692/1, datë 25.03.2019 për pezullimin e tij nga detyra. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në përfundim të gjykimit, me Vendimin nr. 3163, datë 02.12.2020, ka vendosur konstatimin e pavlefshmërisë së aktit administrativ nr. 2692/1, datë 25.03.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve për pezullimin nga detyra të paditësit, E.L. Në vijim, ankuesi është vënë në dijeni se në pozicionin e tij të punës kishin caktuar një punonjës pa arsimin përkatës dhe pa gradën, që kërkonte vendi i punës. Ankuesi informon se për të njëjtin rast apo për raste në rrethana më të rënda ligjore, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, ka rikthyer në punë punonjës të cilët kanë qenë në ndjekje penale, pa u shprehur organi i procedurës për pushimin e çështjes, sikurse është rasti i punonjësve të policisë së burgjeve, I.Ç dhe P.B. Në këto rrethana, është ndjerë i diskriminuar nga institucioni punëdhënës se jo vetëm që nuk ka zbatuar ligjin për rikthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës, por dhe ka kryer një trajtim të pabarabartë me punonjësit e tjerë, të cilët kanë qenë në kushtet e tija ligjore apo më të rënduara”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon ndër të tjera, zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me bindjet politike, pretenduar nga ankuesi, duke parashikuar në nenin 1 të tij se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 3, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 12/1/c², ndalon çdo lloj

² Neni 12/1/c, të ligjit 10221/2010, të ndryshuar: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë

dallimi, kufizimi ose përjashtimi, bazuar në gjendjen arsimore, që i bëhet një punëmarrësi në gëzimin e të drejtës për punësim, duke përfshirë këtu trajtimin gjatë procesit disiplinor.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

- Me shkresën nr. 573/2, datë 23.04.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga, DPB për ankesën e bërë nga E.L si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
 - Kopje të plotë të dosjes së punës së E.L.
 - Kopje të plotë të procedurës së emërimit të punonjësit që ka zëvendësuar E.L në pozicionin “Punonjës i rolit të mesëm” në Sektorin e Forcave Operacionale në DPB, dhe kopje të arsimit dhe gradës së këtij punonjësi.
 - Kopje të plotë të dokumentacionit, lidhur me kthimin në punë të punonjësve, I.Ç dhe P.B.
- Me shkresën nr. 573/3, datë 27.05.2021, “Kujtesë”, Komisioneri, ka kërkuar nga DPB informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar me shkresën nr. 573/2, datë 23.04.2021.

Me shkresën nr. 4349/2, datë 01.06.2021, DPB dërgoi një pjesë të dokumentacionit të kërkuar dhe në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Me shkresën nr. 516, datë 21.03.2019 janë informuar se në ngarkim të punonjësit të rolit të mesëm drejtues E.L ka bërë ankesë punonjësja e Forcave Operacionale D.S, në vijim të së cilës nga Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve (SHKBB) janë kryer veprimet proceduriale të mëtejshme duke e referuar çështjen në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, e cila ka rregjistruar procedimin penal nr. 2876-viti 2019, për veprat penale “Marrëdhënie seksuale ose

vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

homoseksuale duke shpërdoruar detyrën”, të parashikuar në nenin 105 të Kodit Penal. DPB me Urdhërin nr. 2692/1, datë 25.03.2019 “Për pezullimin nga detyra të punonjësit të rolit të mesëm”, ka aplikuar pezullimin nga detyra në bazë të ligjit nr. 10032, datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve”. E.L me shkresën nr. 938-E, datë 27.03.2019, ka ushtruar ankim në DPB. Në trajtimin shterues të elementëve të ngjarjes është zhvilluar dhe një inspektim mbi zbatimin e rregullave dhe disiplinës në detyrë në Sektorin e Forcave Operacionale, i cili me datë 09.04.2019, ka konkluduar në një informacion mbi rastin. Në kuadër të trajtimit dhe zhvillimit të një procesi administrativ transparent, pavarësisht se trajtimi i çështjes ishte referuar në kuadrin penal, është investuar edhe Komisioni i Përhershëm Disiplinor në DPB, i cili me datë 17.04.2019 ka zhvilluar seancën dëgjimore me prezencën e E.L. Komisioni i Përhershëm Disiplinor, nëpërmjet relacionit nr. 2692/5, datë 23.04.2019 ka vendosur lënien në fuqi të masës disiplinore “Pezullim nga detyra e punonjësit të rolit të mesëm”. Në vijim, me datë 07.06.2019, DPB është njohur me kërkesën e E.L adresuar Ministrisë së Drejtësisë sipas së cilës ka kërkuar “Konstatimin e pavlefshëmrisë absolute të urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm me nr. 2692/1, datë 25.03.2019 për pezullim nga detyra të punonjësit të rolit të mesëm”. DPB me shkresën nr. 1728/E-1, datë 20.06.2019 me lëndë “Lidhur me marrëdhënien e punës” ka kthyer përgjigje mbi pretendimet e ngritura duke e informuar se nuk kanë dijeni për vijimësinë e procedimit penal por dhe të faktit se për sqarimin e pozicionit të punës do të njoftohet në vijim nga përfaqësues të saj. Në përfundim të hetimit të çështjes penale në ngarkim të E.L, pasi Gjykata e Rrethit Tiranë me Vendimin datë 30.09.2019 ka vendosur “Pushimin e çështjes”, DPB ka tentuar vijimin e procesit, lidhur me rishikimin e masës disiplinore, por kanë hasur në pengesa të shkaktuara me dashje nga ankuesi, duke mos u paraqitur në takimin e datës 05.11.2019 dhe më vonë duke mos pasur mundësi komunikimi shkresor dhe me celular. Në datë 05.05.2020, pranë DPB është paraqitur një kërkesë nga E.L me objekt “Kërkesë për rikthim në detyrë dhe pagimin e pagave mujore”. Nga ana e Komisionit të Përhershëm Disiplinor, në datë 22.06.2020 është tentuar për organizimin e një seance dëgjimore me ankuesin por që nuk është realizuar. Nisur nga vendimmarrja lidhur me çështjen penale e në vlerësim dhe të ecurisë së procesit gjyqësor administrativ nga ana e DPB me Urdhërin nr. 10212, datë 09.10.2020 është vendosur për përfundimin e pezullimit nga detyra dhe kthimin në detyrë të punonjësit të rolit të mesëm. Lidhur me gradën dhe arsimin e punonjësit që ka zëvendësuar gjatë periudhës së pezullimit, DPB informon se pozicioni i punës së E.L është mbuluar me procedurën e komandimit pa pasur asnjë ndryshim punonjësi që do mbulonte pozitën financiare që lidhen me pozicionin e punës së ankuesit (pra për këtë funksion nuk është trajtuar askush me pagë e as emëruar në detyrë duke u ruajtur pozicioni i punës). Për vetë natyrën që ka ky funksion nuk e lejon gjendjen e vakancës pasi sektori është i rëndësishëm e me dinamikë të vazhdueshme dhe me një risk të lartë sigurie, ndaj natyrisht për mbarëvajtjen e punës ka lindur nevoja për mbulimin e këtij pozicioni pune nga një punonjës tjetër i stafit policor i nivelit të mesëm drejtues, i propozuar nga Drejtoria e Policisë me mekanizmin e komandimit. Lidhur me pretendimin se për të njëjtin rast apo për raste në rrethana më të rënda ligjore, DPB ka rikthyer në punë punonjës të cilët kanë qenë në ndjekje penale pa u shprehur organi i akuzës për pushimin e çështjes, sikurse është rasti i punonjësve të policisë së burgjeve I.Ç dhe P.B, evidentojmë se: në rastin e punonjësit të rolit bazë P.B, DPB ka

vepruar në koherencë të plotë me parashikimet e ligjit për policinë e Burgjeve, duke urdhëruar pezullimin nga detyra të katër punonjësve menjëherë sapo është marrë dijeni për fillimin e procedimit penal për shpërdorim detyre. Lidhur me pretendimin për mostrajtim të barabartë me punonjës in I.Ç, informohet se në dosjen personale të këtij punonjësi, nuk administrahet asnjë e dhënë lidhur me fakte apo dokumentacion që ky punonjës është marrë ndonjëherë në përgjegjësi penale. Në përfundim, DPB gjykon se me veprimet/mosveprimet e saj nuk ka cënuar në asnjë moment të drejtat që ligji i parashikon E.L, madje ka intensifikuar punën dhe investuar strukturat kompetente për sqarimin dhe qartësimin e pozitës së tij pavarësisht ngërçit të shkaktuar nga mungesa e komunikimit si pasojë e veprimeve të E.L”.

Në përgjigje të shkresës së dërguar nga DPB, subjekti ankues, me shkresën protokolluar me tonën me nr. 573/4, datë 11.06.2021, në mes të tjerash informon Komisionerin se: “Lidhur me përgjigjen e DPB, konstatoj se është bërë në frymë justifikuese duke mos iu përmbajtur në mënyrë të saktë interpretimit ligjor të dispozitave ligjore, të cilat rregullojnë marrëdhëniet administrative, financiare, etj, të punonjësve të Policisë së Burgjeve, përcaktuar në ligjin nr. 10032, datë 11.12.2008 “Për policinë e Burgjeve”, i ndryshuar, ligj i cili ka qenë në fuqi në periudhën kohore që i referohemi objektit të ankesës.

Konkretisht: 1. DPB pranon se ka bërë pezullimin me Urdhërin nr. 269/1, datë 25.03.2019 në bazë të ligjit nr. 10032, datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve”, i ndryshuar, me arsyetimin se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, kishte regjistruar procedimin penal nr. 2876, viti 2019 për veprën penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën”, parashikuar nga neni 105 i Kodit Penal.

2. Urdhëri i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve për pezullimin nga detyra, është bazuar në nenin 20, pika 1 dhe 42 të ligjit nr. 10032, datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve”, i ndryshuar. Në ankim, është shprehur se akti administrativ Urdhëri nr. 2692/1, datë 25.03.2019 “Për pezullimin nga detyra e punonjësit të rolit të mesëm” të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, është absolutisht i pavlefshëm sepse: 1. Në zbatim të pikës 2 të nenit 20 të ligjit 10032/2008, nuk ka një propozim të Drejtorit të Policisë së Burgjeve drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, ku të kërkohet pezullimi i tij. Në vështrim të përmbajtjes së nenit 42 “Procedimi penal” të ligjit 10032/2008, kusht i domosdoshëm është se pezullimi bëhet vetëm kur punonjësi i Policisë së Burgjeve merret në përgjegjësi penale për një krim. Nga të gjitha aktet shkresore me cilësinë e provës, rezulton e provuar se: Procedimi penal nr. 2876, viti 2019, është regjistruar në datën 12.04.2019 pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pra shumë ditë pas nxjerrjes së Urdhërit nr. 2692/1, datë 25.03.2019 “Për pezullimin nga detyra e punonjësit të rolit të mesëm”, të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve; Në asnjë moment të hetimeve paraprake, emri E.L nuk është shënuar si person të cilit i atribuohet vepra penale, pra person nën hetim në Regjistrin e Njoftimit të Veprave Penale (procedimeve penale) pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë; Për rrjedhojë, nuk mund të ishte subjekt i zbatimit të përmbajtjes ligjore parashikuar në nenin 20 dhe nenin 42 të ligjit 10032/2008 “Për policinë e Burgjeve”, i ndryshuar. Ankuesi informon se nga DPB nuk ishte njoftuar fillimi i ndonjë procedure

administrative me objekt të përcaktuar në drejtim të veprimtarisë, si specialist i Sektorit të Forcave Operacionale pranë Policisë së Burgjeve. Konstatimin e pavlefshërisë absolute të urdhërit për pezullimin e tij nga detyra, ankuesi e ka bërë objekt të shqyrtimit gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila me Vendimin nr. 3163 (80-2020-3185), datë 02.12.2020, ka vendosur konstatimin e pavlefshmërisë së aktit administrativ nr. 2692/1, datë 25.03.2019 “Për pezullimin nga detyra të punonjësit të rolit të mesëm E.L. Lidhur me zbatimin e procedurave për fillimin e marrëdhënieve të punës, pranë DPB, ankuesi thekson se nuk është objekt i ankimit pranë KMD-së. Lidhur me pretendimin se është zëvendësuar nga një person me gradë e arsim më të ulët, ankuesi sqaron se: DPB nuk ka treguar konkretisht se cili punonjës i rolit të mesëm është komanduar në pozicionin e tij, çfarë grade dhe arsimit kishte ky punonjës dhe si është motivuar komandimi i tij. Lidhur me trajtimin e pabarabartë edhe të punonjësve të tjerë, DPB justifikohet se për punonjës të I.Ç, nuk administrohet asnjë dokumentacion që është marrë në përgjegjësi penale ndonjëherë, sqarohet se: Pikërisht në këtë justifikim DPB, vërtetohet qartë standarti i dyfishtë dhe qëndrimi paragjyqës e diskriminues ndaj tij, pasi ndërsa për punonjës të I. Ç shprehet se nuk ka asnjë dokumentacion që është marrë në përgjegjësi penale, në rastin e tij, DPB ka vepruar në mënyrë të menjëhershme dhe pa bërë as verifikimin më të vogël pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Është njoftuar nëpërmjet të gjitha mjeteve të medias së shkruar dhe vizive se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka filluar procedimin penal në lidhje me 5 tenderat e zhvilluar në Ministrinë e Drejtësisë për periudhën kohore 2016-2017 dhe me kërkesë të prokurorit të çështjes dhe me vendim të gjykatës, në datën 09.02.2019, është vendosur masa e sigurimit detyrim paraqitje për shtetasit: M.A, D.M, A.A, O.G, E.SH, E.V, O.B dhe I.Ç”.

- Mbështetur në nenin 33/8, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 72, datë 19.04.2021, Komisioneri me shkresën nr. 573/5, datë 01.07.2021 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 09.07.2021, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e tyre dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe provat e palëve në proces si dhe kërkoi informacion dhe dokumentacion, si më poshtë:
 - Kopje të plotë të procedurës së emërimit të punonjësit që ka zëvendësuar E.L në pozicionin “Punonjës i rolit të mesëm” në Sektorin e Forcave Operacionale në DPB, dhe kopje të arsimit dhe gradës së këtij punonjësi.

Seanca u zhvillua me praninë e palëve në proces: subjektit ankues, E.L dhe përfaqësuesi i tij, avokat P.B dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësuesit të DPB, z. Z.Gj me detyrë Inspektor i Çështjeve Ligjore dhe Sigurisë në DPB³.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

³ Referuar autorizimit nr. 4349/4, datë 08.07.2021 të lëshuar nga DPB.

Gjatë seancës dëgjimore, të dyja palët iu qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Lidhur me procedimin penal nr. 2876 të vitit 2019 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Bazuar në kërkesën e Prokurorisë Tiranë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Vendimin nr. 3977 Akti, datë 30.09.2019 (i cili ka marrë formë të prerë në datë 17.10.2019, pasi nuk është ankimuar), ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. 2876 viti 2019 për veprën penale “*Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën*”, të parashikuar nga neni 105 i Kodit Penal. Në arsyetimin e vendimit, gjykata në mes të tjerash, ka vlerësuar se: “*Në rastin konkret nuk provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm që i kallëzuari (E.L) të ketë kryer veprime që përmbajnë elementë të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 105 të Kodit Penal*”.

Lidhur me kundërshtimin në gjykatë, të Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, nr. 2692/1, datë 25.03.2019 “Për pezullimin nga detyra të punonjësit të rolit të mesëm, E.L”.

Bazuar në dokumentacionin e sjellë nga palët, rezulton se: E.L duke mos rënë dakord me Urdhërin nr. 2692/1, datë 25.03.2019 “*Për pezullim nga detyra*”, i është drejtuar me kërkesëpadi⁴, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në të cilën ka kërkuar: - Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ: Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nr. 2692/1, datë 25.03.2019 “*Për pezullimin nga detyra të punonjësit të rolit të mesëm, E.L*”.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. 3163 (80-2020-3185), datë 02.12.2020, ka vendosur: -Konstatimin të pavlefshëm të aktit administrativ 2692/1, datë 25.03.2019, të D.P.Burgjeve Tiranë për “Pezullim nga detyra” të paditësit E.L.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Ligji 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikon se: “*“Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi*”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

⁴ Nr. Regj.Them. 5255/725.(31157-06721-80, datë 04.11.2019.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

LMD, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, ka përcaktuar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”*.

Rezulton se në datë 25.6.2020 Parlamenti i Republikës së Shqipërisë ka miratuar ligjin e ri nr. 80/2020 *“Për Policinë e Burgjeve”*. Ky ligj ka shfuqizuar ligjin nr. 10032, datë 11.12.2008, *“Për Policinë e Burgjeve”*, të ndryshuar. Në kohën kur pretendohet se ka ndodhur diskriminimi ka qenë në fuqi ligji nr. 10032, datë 11.12.2008, *“Për Policinë e Burgjeve”*, i ndryshuar, për këtë arsye Komisioneri do t'i referohet këtij ligji si legjislacioni i zbatueshëm për shqyrtimin e ankesës së E.L.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm të ankuesit.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se ankuesi E.L, me Urdhrin nr. 5929, datë 12.06.2018 *“Për emërim në detyrë të punonjësit të rolit të mesëm”*, është emëruar në detyrën *“Specialist”* me gradën *“K/Komisar”* në Sektorin e Forcave Operacionale pranë DPB.

Drejtoria e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Sistemin e Burgjeve (SHKBB) me shkresën nr. 516, datë 21.03.2019 ka vënë në dijeni DPB, se bazuar në deklarinimin e shtetasës D.S (punonjëse e rolit bazë të Forcave Operacionale të DPB), ka kryer veprimet procedurale të nevojshme, dhe materialet procedurale me shkresën nr. 512, datë 21.03.2019, i janë referuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në ngarkim të shtetasit E.L për veprat penale të parashikuara nga neni 105 dhe 119 të Kodit Penal.

Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve, me Urdhrin nr. 2692/1, datë 25.03.2019 *“Për pezullimin nga detyra të punonjësit të rolit të mesëm”* ka urdhëruar që: *“K/Komisar Edmond Levanaj, me detyrë “Punonjës i rolit të mesëm” në Sektorin e Forcave Operacionale në DPB, të pezullohet nga detyra. Ankuesi me shkresën nr. 938-E, datë 27.03.2019, drejtuar DPB, është ankuar lidhur me urdhërin e pezullimit. DPB në shqyrtim të ankesës së E.L ka zhvilluar një inspektim lidhur me zbatimin e rregullave dhe disiplinës në detyrë tek Forcat Operacionale, nga ana e Specialistit të Policisë, K/Komisar E.L dhe ka informuar Drejtorin e Përgjithshëm me shkresën nr. 3271, datë 09.04.2019 “Informacion mbi verifikimet lidhur me ankesën e E.L”*. Në këtë shkresë është informuar Drejtori i Përgjithshëm i DPB, lidhur me procedurat e emërimit dhe marrjes së gradës

të E.L dhe nuk ka të shkruar asnjë informacion lidhur me zbatimin e rregullave dhe disiplinës në detyrë, nga ana e E.L.

Në datë 17.04.2019 është zhvilluar një takim⁵ mes Komisionit të Disiplinës të DPB dhe ankuesit, për shqyrtimin e praktikës disiplinore nr. 2667, datë 03.04.2019 të dërguar nga Ministria e Drejtësisë ndaj E.L. Komisioni i Përhershëm Disiplinor i DPB, nëpërmjet relacionit nr. 2692/5, datë 23.04.2019 ka vendosur lënien në fuqi të masës disiplinore “Pezullim nga detyra e punonjësit të rolit të mesëm”.

Subjekti ankues me shkresën datë 28.05.2019⁶, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë ka kërkuar “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 2692/1, datë 25.03.2019 për pezullim nga detyra të punonjësit të rolit të mesëm-E.L”.

Me shkresën nr. 1728/E-1, datë 20.06.2019 me lëndë “Lidhur me marrëdhënien e punës”, DPB ka kthyer përgjigje ankuesit mbi pretendimet e ngritura duke e informuar në mes të tjerash, se nuk kanë dijeni për vijimësinë e procedimit penal por dhe të faktit se për shkak të shkeljeve të konstatuara në kriteret e përgjithshme për tu pranuar në Policinë e Burgjeve, mendojnë që të ndërpresin kontratën e punës dhe për sqarimin e pozicionit të punës do të njoftohet në vijim nga përfaqësues të DPB.

Në vijim ankuesi me shkresën protokolluar në Ministrinë e Drejtësisë nr. I-107, datë 06.08.2019, ka kërkuar përsëri konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 2692/1, datë 25.03.2019 për pezullim nga detyra të punonjësit të rolit të mesëm-E.L”, dhe nga Ministria e Drejtësisë ka marrë përgjigje se mund ti drejtohet gjykatës kompetente për këtë çështje.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Vendimin nr. 3977 Akti, datë 30.09.2019, ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. 2876 viti 2019 për veprën penale “*Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën*”, të parashikuar nga neni 105 i Kodit Penal.

Me shkresat datë 04.11.2019, 15.01.2020, 16.01.2020 drejtuar ankuesit dhe avokatit të tij, dhe disa telefonatave drejtuar E.L, DPB ka tentuar vijimin e procesit, lidhur me rishikimin e masës disiplinore, por që nuk kanë arritur të kontaktojnë me ankuesin.

Subjekti ankues, me shkresën datë 05.05.2020 të protokolluar në DPB me nr. 1049/E, datë 05.05.2020 ka kërkuar rikthimin në detyrë dhe pagesën e pagave mujore.

Nisur nga vendimmartja lidhur me çështjen penale ndaj E.L, DPB me Urdhërin nr. 10212, datë 09.10.2020 vendosi përfundimin e pezullimit të K/Komisar E.L dhe rikthimin e tij në detyrën e Specialistit të Policisë pranë Forcave Operacionale në DPB.

⁵ Referuar Proces-Verbalit nr. 2692/4, datë 17.04.2019.

⁶ Protokolluar në Ministrinë e Drejtësisë nr. E-50/3, datë 28.05.2019, dhe në DPB nr. 1278/E, datë 07.06.2019.

Lidhur me ligjshmërinë e Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, nr. 2692/1, datë 25.03.2019 “Për pezullimin nga detyra të punonjësit të rolit të mesëm, E.L”, është shprehur Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, e cila me Vendimin nr. 3163 (80-2020-3185), datë 02.12.2020, ka konstatuar pavlefshërinë e aktit të pezullimit nga detyra, të paditësit E.L dhe në mes të tjerash ka arsyetuar se: *“..në kohën e nxjerrjes së aktit objekt gjykimi në ngarkim të paditësit nuk ka pasur asnjë procedim penal të rregjistruar, çka është kusht i damosdoshëm që drejtori i përgjithshëm të marrë vendim pezullimi sipas asaj çfarë përcakton neni 42 i ligjit 10032/2008, “Për policinë e burgjeve”, i cili ka të përcaktuar saktë se pezullimi bëhet vetëm në rast kur “...punonjësi i Policisë së Burgjeve merret në përgjegjësi penale për një krim, pezullohet nga funksioni deri në përfundim të procesit””*.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga palët, nuk rezulton asnjë dokument me të cilin të vërtetohet se nga ana e DPB është marrë masë disiplinore për punonjësin E.L, sipas parashikimit të nenit 36⁷ të ligjit 10032, datë 11.12.2008, “Për Policinë e Burgjeve”, i ndryshuar.

Nga ana e DPB, edhe pse iu kërkua⁸ që dërgonte dokumentacionin për fillimin dhe përfundimin e procedurës për shkelje disiplinore, nga ana e saj nuk u vendos në dispozicion të Komisionerit asnjë dokument që të provonte deklaratën⁹ e bërë nga përfaqësuesi i saj gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore se: *“..ndaj E.L, komisioni ka filluar procedim disiplinor për shkelje të rregullave të etikës në punë, përdorimi i pozicionit të punës, gjithmonë i dyshuar për favore..”*.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht se ankuesi është njoftuar disa herë nga DPB për tu paraqitur në institucion lidhur me diskutimin e marrëdhënieve të punës, ndaj tij nuk ka pasur asnjë masë disiplinore, sipas parashikimit të nenit 36¹⁰ të ligjit 10032, datë 11.12.2008,

⁷ Neni 36. Masat disiplinore.

1. Kur punonjësi i Policisë së Burgjeve nuk zbaton detyrat e shërbimit ose shkel rregullat e parashikuara në këtë ligj dhe në aktet e tjera, ligjore dhe nënligjore, që lidhen me detyrën dhe këto veprime nuk përbëjnë vepra penale, ndaj tij mund të jepet njëra nga këto masa disiplinore:

- a) vërejtje me shkrim;
- b) vërejtje me paralajmërim;
- c) pezullim pa të drejtë page nga një deri në tre muaj;
- ç) ulje në gradë ose funksion;
- d) largim nga detyra.

2. Masa disiplinore duhet të jetë në përputhje me shkeljen e kryer dhe pasojat e ardhura prej saj.

3. Efektet e masës disiplinore fillojnë pasi të ketë përfunduar procesi disiplinor, ku përfshihen procedurat përkatëse të apelimit dhe pasi të jetë dhënë vendimi përfundimtar.

⁸ Referuar kërkesës së inspektorit të çështjes, min. 41.20.

⁹ Referuar deklaratimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore, min 41.30.

¹⁰ Neni 36. Masat disiplinore.

1. Kur punonjësi i Policisë së Burgjeve nuk zbaton detyrat e shërbimit ose shkel rregullat e parashikuara në këtë ligj dhe në aktet e tjera, ligjore dhe nënligjore, që lidhen me detyrën dhe këto veprime nuk përbëjnë vepra penale, ndaj tij mund të jepet njëra nga këto masa disiplinore:

- a) vërejtje me shkrim;
- b) vërejtje me paralajmërim;
- c) pezullim pa të drejtë page nga një deri në tre muaj;
- ç) ulje në gradë ose funksion;
- d) largim nga detyra.

2. Masa disiplinore duhet të jetë në përputhje me shkeljen e kryer dhe pasojat e ardhura prej saj.

“Për Policinë e Burgjeve”, i ndryshuar, për më tepër që dhe në urdhërin për përfundimin e pezullimit dhe kthimit të ankuesit në detyrë, DPB i është referuar vetëm vendimit të gjykatës për pushimin e procedimit penal nr. 2876/2019, dhe jo ndonjë mase disiplinore të dhënë ndaj E.L.

Subjekti ankues në ankesën e bërë pranë Komisionerit, por dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore ka pretenduar se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë krahasuar me punonjësit, I.Ç dhe P.B, të cilët kanë qenë në kushtet e tija ligjore, por janë trajtuar ndryshe.

Për të vlerësuar në lidhje me pretendimet e ankuesit, Komisioneri kërkoi nga DPB, që të shpjegonte arsyet e trajtimit të pabarabartë të ankuesit me punonjësit I.Ç dhe P.B. Lidhur me këtë, DPB dërgoi dokumentacionin lidhur me punonjësin P.B dhe informoi se në dosjen personale të punonjësit I.Ç, nuk administrahet asnjë e dhënë lidhur me fakte apo dokumentacion që ky punonjës është marrë ndonjëherë në përgjegjësi penale. Lidhur me faktimin e pretendimit për trajtim të pabarabartë me punonjësin I.Ç, subjekti ankues shpjegoi¹¹ se informacioni mbi procedimin penal të I.Ç është i publikuar në media, ndërsa përfaqësuesi i DPB deklaroi se në institucion, nuk ka asnjë informacion zyrtar lidhur me procedimin penal apo ndonjë masë sigurie për punonjësin I.Ç. Në këto kushte, në mungesë të dokumentacionit dhe informacionit zyrtar, Komisioneri nuk do marrë në shqyrtim, pretendimin për punonjësin I.Ç.

Nga verifikimet e bëra në dokumentacionin e dërguar nga palët, rezulton se me Vendimin nr. 482, datë 22.06.2017, Gjykata e Shkallës së Parë Elbasan ka caktuar masën e sigurimit “Arrest me burg” të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale ndaj personit nën hetim P.B¹², në vijim me Urdhërin nr. 5725, datë 23.06.2017 të DPB janë pezulluar nga detyra nga data 23.06.2017, deri në një urdhër të dytë, punonjësit e rolit bazë: G.M, V.K, A.A dhe P.B. Me Urdhërin nr. 7482, datë 20.07.2018, të DPB është urdhëruar përfundimi i pezullimit të punonjësve të rolit bazë: G.M, V.K, A.A dhe P.B, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me Vendimin nr. 1627/472, datë 02.07.2018 (të marrë formë të prerë në datë 17.07.2018) kishte vendosur pushimin e çështjes penale në ngarkim të punonjësve të mësipërm.

Në nenin 42 të ligjit nr. 10032, datë 11.12.2008, “Për Policinë e Burgjeve”, i ndryshuar, parashikohet: Procedimi penal; “Në rastet kur punonjësi i Policisë së Burgjeve merret në përgjegjësi penale për një krim, pezullohet nga funksioni deri në përfundim të procesit”.

Në përfundim të analizimit të sa më sipër, lidhur me procedurën e ndjekur për punonjësin P.B, Komisioneri vlerëson se, praktika e ndjekur dhe zbatuar nga ana e DPB është në përputhje të plotë me parashikimet e ligjit 10032, datë 11.12.2008, “Për Policinë e Burgjeve”, të ndryshuar, për trajtimin e këtij rasti.

Lidhur me zëvendësimin e E.L, rezulton se: Me Urdhërin nr. 2750/1, datë 25.03.2019 të DPB, është urdhëruar, komandimi i N/Komisar SH.P, me detyrë “Specialist informacioni” në IEVP

3. Efektet e masës disiplinore fillojnë pasi të ketë përfunduar procesi disiplinor, ku përfshihen procedurat përkatëse të apelit dhe pasi të jetë dhënë vendimi përfundimtar.

¹¹ Referuar deklaramëve të palëve në seancën dëgjimore datë 09.07.2021, min. 21.00 dhe 42.50.

¹² Referuar Vendimit nr. 1627/472, datë 02.07.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Fushë-Krujë, në detyrën e “Specialist” në Sektorin e Forcave Operacionale pranë DPB, nga data 26.03.2019 deri në daljen e një urdhri të dytë. Referuar Diplomës me nr. regj 1614, datë 27.10.2004, të lëshuar nga Akademia Ushtarake “Skënderbej”, SH.P është diplomuar si Oficer në specialitetin, Artileri Tokësore.

Në nenin 26/2/b të ligjit nr. 10032, datë 11.12.2008, “Për Policinë e Burgjeve”, të ndryshuar, parashikohet: Gradat: “1. Gradat shprehin pozitën, që ka punonjësi në strukturën hierarkike të Policisë së Burgjeve. 2. Emërtimet e gradave, sipas roleve dhe ecurisë në karrierë, janë:

- a) për punonjësit e rolit bazë:
 - i) nëninspektor;
 - ii) inspektor;
 - iii) kryeinspektor;
- b) për punonjësit e rolit të mesëm:
 - i) nënkomisar;
 - ii) komisar;
 - iii) kryekomisar;
- c) për punonjësit e rolit të lartë.....;”

Në analizë të të dhënave të referuara më sipër, rezulton se punonjësi i komanduar SH.P, që ka zëvendësuar ankuesin është brenda parashikimit ligjor për gradat, për punonjësit e rolit të mesëm, të përcaktuar në ligjin 10032/2008, “Për Policinë e Burgjeve”, të ndryshuar.

Në përfundim të provave të administruara, Komisioneri konstaton se:

- Referuar Vendimit nr. 3163 (80-2020-3185), datë 02.12.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ankuesi është pezulluar me pa të drejtë nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, pasi në datë 25.03.2019, kur është nxjerrë urdhri për pezullimin e E.L, në ngarkim të tij nuk ka pasur asnjë procedim penal të rregjistruar, sipas përcaktimit të nenit 42 të ligjit 10032/2008, “Për policinë e burgjeve”, të ndryshuar.
- Nuk rezulton asnjë dokument me të cilin të vërtetohet se nga ana e DPB është marrë masë disiplinore për punonjësin E.L, sipas parashikimit të nenit 36¹³ të ligjit 10032, datë 11.12.2008, “Për Policinë e Burgjeve”, të ndryshuar.

¹³ Neni 36. Masat disiplinore.

1. Kur punonjësi i Policisë së Burgjeve nuk zbaton detyrat e shërbimit ose shkel rregullat e parashikuara në këtë ligj dhe në aktet e tjera, ligjore dhe nënligjore, që lidhen me detyrën dhe këto veprime nuk përbëjnë vepra penale, ndaj tij mund të jepet njëra nga këto masa disiplinore:

- a) vërejtje me shkrim;
- b) vërejtje me paralajmërim;
- c) pezullim pa të drejtë page nga një deri në tre muaj;
- ç) ulje në gradë ose funksion;
- d) largim nga detyra.

2. Masa disiplinore duhet të jetë në përputhje me shkeljen e kryer dhe pasojat e ardhura prej saj.

3. Efektet e masës disiplinore fillojnë pasi të ketë përfunduar procesi disiplinor, ku përfshihen procedurat përkatëse të apelimit dhe pasi të jetë dhënë vendimi përfundimtar.

- Pavarësisht faktit që ankuesi, kishte kërkuar disa herë lidhur me pavlefshërinë e urdhrit të pezullimit, nga ana e DPB nuk u mor në konsideratë për tu analizuar vendimi i pezullimit, brenda një afati të arsyeshëm¹⁴.

Nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri vlerëson se, ankuesi i është nënshtruar një trajtimi të paligjshëm, të padrejtë dhe të pafavorshëm, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, lidhur me lëshimin e urdhrit për pezullimin nga detyra të E.L.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2¹⁵, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ky ligj, ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Referuar formularit të ankesës, subjekti ankues pretendon së është diskriminuar për shkak të gjendjes arsimore dhe çdo shkak tjetër.

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ligji ka bërë në nenin 3, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Neni 1, i ligjit, liston disa shkaqe, megjithatë kjo listë nuk është shteruese, por ilustruese, fakt ky që rezulton nga përfshirja në këtë listë e shprehjes “për çdo shkak tjetër”.

Referuar dokumentacionit të arsimit të E.L, rezulton se me Diplomën nr. regj 1355/3, datë 07.02.2000, të lëshuar nga Akademia Ushtarake “Skënderbej”, është diplomuar si Oficer në

¹⁴ DPB rreth 12 muaj nga vendimi i gjykatës për pushimin e procedimit penal nr. 2876/2019, ka vendosur përfundimin e pezullimit dhe rikthimin e ankuesit në detyrë.

¹⁵ “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

specialitetin, Këmbësori dhe me Diplomën nr. matrikullimi 2660, datë 11.11.2010, të lëshuar nga Universiteti “Kristal”, është diplomuar me diplomë të nivelit të parë në Drejtësi.

Në formularin e ankesës, E.L pretendon se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë pasi ishte zëvendësuar nga një punonjës një punonjës pa arsimin përkatës dhe pa gradën, që kërkonte vendi i punës.

Në këtë kuptim shkak i gjendjes arsimore të pretenduar nga ankuesi, konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi jo vetëm parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe sepse ekzistojnë prova të mjaftueshme, që provojnë se ai e mbart këtë shkak, dhe diferencat në trajtim bazuar në këtë shkak janë të ndaluara dhe të mbrojtura nga ligji.

Subjekti ankues në rastin në fjalë, për të provuar “çdo shkak tjetër” nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale specifike të tij.

Sa i takon pretendimit të tij për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, i pa dokumentuar dhe i paprovuar, Komisioneri vlerëson se nuk qëndron, pasi ai nuk është “shkak” në vetvehte.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.

Për të vërtetuar faktin, se subjekti ankues është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, duhet të ekzistojë një lidhje objektive shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur të pretenduar nga ankuesi dhe të parashikuar nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe trajtimit të padrejtë, të pabarabartë apo të pafavorshëm të tij.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Kushtetuta si akti themeltar i Republikës së Shqipërisë, sanksionon se: “*Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme, të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik*”. Neni 18, pika 2, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon shprehimisht: “*Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore*”.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), në nenin 14 të saj, ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë shoqërore shkaqesh. Ndërkohë Protokollin 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtuar nga ligji”

dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: “çdo dallim, përrjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3, pika 2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Në nenin 12, pika 1, gërma c), të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: “1. Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përrjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Neni 9, pikat 9 dhe 10, të Kodit të Punës parashikojnë shprehimisht: “9. Në rastin kur një person pretendon se është cënuar nga moszbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, sipas këtij Kodi, ndiqet procedura e ankimit, e përcaktuar në ligjin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi. 10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë”.

Kodi i Procedurës Administrative¹⁶, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila duhet të provojnë se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, për shkakun e pretenduar.

¹⁶ Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

LMD, i ndryshuar, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, që duhet të provojë se ankuesi nuk është ekspozuar ndaj një qëndrimi të padrejtë dhe disfavorizues për shkak të gjendjes arsimore.

Kështu, neni 33, pika 7/1 i LMD, të ndryshuar, përcakton se: “Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.

Parimi i ndarjes së barrës së provës është një parim i mirënjohur tashmë në legjislacionin e BE-së dhe KEDNJ. KEDS¹⁷ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të duhur.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se prima facie është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Kjo mund të realizohet në njërin nga dy mënyrat e mëposhtme:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv. Nëse subjekti, i cili pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.¹⁸

Në lidhje me rastin në fjalë, bazuar në Vendimin nr. 3163 (80-2020-3185), datë 02.12.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe mbështetur në analizimin e fakteve dhe provave të ankuesit, si dhe në bazë të rezultateve që dolën nga procedura e shqyrtimit të ankesës, Komisioneri ka vlerësuar se ekziston një trajtim i paligjshëm, i padrejtë dhe i pafavorshëm i ankuesit nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, gjatë procedurës së pezullimit nga

¹⁷ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

¹⁸ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

detyra, sipas parashikimit të nenit 42 të ligjit 10032/2008, “Për Policinë e Burgjeve”, të ndryshuar, dhe rikthimit në detyrë.

Përsa i përket gjendjes arsimore të ankuesit, mbështetur në dokumentacionin e depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, rezulton se ankuesi është i diplomuar në vitin 2000 nga Akademia Ushtarake “Skënderbej”, dhe në vitin 2010 nga Universiteti “Kristal” në Fakultetin e Drejtësisë dhe kur është emëruar në detyrën e punonjësit të rolit të mesëm, dhe kur është rikthyer në detyrë, ka pasur të njëjtën gjendje arsimore.

Provat e administruara nuk krijojnë një nivel të tillë provueshmërie që të tregojnë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e padrejtë të ankuesit është shkaku i gjendjes arsimore të ankuesit.

Duke u bazuar në standartin e provueshmërisë të parashikuar nga neni 82/2 i K.Pr.Administrative dhe neni 9/10 i Kodit të Punës, Komisioneri vlerëson se pavarësisht faktit të konstatimit të trajtimit të paligjshëm, të padrejtë dhe të pafavorshëm ndaj ankuesit dhe ekzistencës së shkakut të mbrojtur, faktet dhe provat e administruara janë të pamjaftueshme për të prezumuar se kjo sjellje të cilës i është nënshtruar ankuesi është si rezultat i posedimit të këtij shkakut dhe se në mungesë të tij ankuesi do të ishte trajtuar ndryshe. Sjellja diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo paligjshmëri përbën diskriminim.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk e ka diskriminuar ankuesin në të drejtën e tij për punësim, për shkak të gjendjes arsimore. Për rrjedhojë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk ka shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Për sa më sipër, nga analizimi i të gjitha fakteve dhe provave të administruara gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se trajtimi i paligjshëm, i padrejtë dhe i pafavorshëm i ankuesit nuk ka ardhur për shkak të gjendjes së tij arsimore.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/c, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të E.L, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme e Burgjeve, për shkak të gjendjes arsimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA